

# **RELACION (Draft)**

## **PËR**

### **PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT**

#### **“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE, 2017-2027”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi i propozuar për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit ka si qëllim miratimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, i cili është përgatitur në kuadrin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të financuar nga Banka Botërore me nr. Ref. MEFWA/CS/003 “Përgatitja dhe Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore”, në kuadër të Komponentit 3 të projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes. Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SMIBU) është përgatitur nga konsulenti Mott MacDonald, në bashkëpunim me Abkons dhe GR Albania, i financuar nga Banka Botërore dhe SIDA.

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore, 2017-2027 (SKMIBU) është dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave për zhvillimin e planeve dhe dokumentave të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, shëndetit publik dhe përmban edhe dokumente të tjera përkatëse.

Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore (MIBU) përkufizohet si “një proces që nxit zhvillimin dhe menaxhimin e bashkërenduar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, për të rritur në maksimum mirëqenien ekonomike dhe sociale, në mënyrë të barabartë dhe pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetësore”.

Menaxhimi i integruar i burimeve ujore (MIBU) në vend do të arrihet nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor, ekonomik, institucionale, teknike dhe sociale duke u bazuar në legjislacionin Evropian për mjedisin dhe parimet e MIBU-s.

Proçesi i zhvillimit të Strategjisë MIBU për Shqipërinë është hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një kornizë për administrimin gjithëpërfshirës të burimeve ujore,

në të cilin të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe sektorin privat, shoqërinë civile dhe komunitetet përdoruese, pavarësisht nga gjinia, të luajnë një rol aktiv.

Strategjia integron objektivat e politikave ekzistuese shqiptare duke marrë parasysh rreziqet që pritet të vijnë nga ndryshimet klimatike bazuar në katër ‘shtylla’ strategjike: ‘Ujë për Njerëzit’, ‘Ujë për Ushqim’, ‘Ujë për Industrinë’, dhe ‘Ujë për Mjedisin’.

### **Strategjia MIBU përcakton 5 Objektiva Strategjike që kërkojnë një vëmendje të veçantë:**

1. **Sasia e Ujit:** sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm të të gjitha burimeve ujore, që i shërben të gjitha interesave nëpërmjet zbatimit të direktivave të BE-së;
2. **Cilësia e Ujit:** sigurimi i një cilësie të mirë të ujit të të gjitha burimeve ujore, duke arritur statusin e “gjendjes së mirë të ujit” deri në vitin 2027, nëpërmjet zbatimit të direktivave të BE-së;
3. **Rreziqet nga Uji:** ulja e rreziqeve që vijnë nga uji (përmbytjet dhe thatësitrat) përmes menaxhimit dhe investimeve, që i shëben të gjitha interesave nëpërmjet zbatimit të direktivave të BE-së;
4. **Informacion për Ujin:** sigurimi i modeleve dhe të dhënave të njohura gjerësisht si të besueshme rreth ujit dhe klimës për të gjitha palët e interesit dhe dhënia e këshillave qeverisë për hartimin e politikave për ujin duke u bazuar mbi këto të dhëna dhe modele;
5. **Administrimi i Ujit:** menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, në shërbim të gjitha interesave duke ofruar përfitime social-ekonomike të barabarta nga përdorimi i ujit dhe përfshirje në vendimmarrje për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore MIBU dhe të BE-së.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Strategjia MIBU është në përputhje me programin politik të Këshillit të ministrave. Projektvendimi për miratimin e këtij dokumenti është parashikuar në Programin analitik të akteve për vitin 2017 (katërmujori I, 2017) si dhe në PKIE 2017-2010, kapitulli 27 “Mjedisi”, fusha e menaxhimit të ujërave.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektvendimi është hartuar si kërkesë për plotësimin me aktet përkatëse nënligjore të Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të Burimeve ujore”. Strategjia Kombëtare MIBU është zhvilluar në kuadër të projektit “Burimet Ujore dhe të Ujitjes (PBUU)”. Projekti zbatohet nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), me financim në formë huaje nga Banka Botërore (BB) dhe financim në formë granti nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

Megjithëse uji në Shqipëri duket sikur është një burim i pashtershëm, Qeveria e Shqipërisë e ka përcaktuar ujin si një çështje me përparësi për shkak të kërkesave të ndryshme dhe, ndonjëherë në konkurrencë me njëra-tjetrën, të sektorëve të ndryshëm të ujit.

Me qëllim menaxhimin e cilësisë, sasisë dhe rreziqeve që i kanosen burimeve ujore në mënyrë të qëndrueshme, nevojitet një strategji gjithëpërfshirëse e burimeve ujore e cila siguron:

- ujë, në sasi dhe cilësi të mjaftueshme për konsum nga popullsia dhe kafshët;
- prodhimin e sigurt të ushqimit;
- përdorim të balancuar të burimeve ujore për prodhim të energjisë dhe qëllime të tjera industriale;
- mbrojtjen e habitateteve, ekosistemeve dhe biodiversitetit që varet nga uji;
- mbrojtjen ndaj ndotja e ujit, përmytjeve dhe thatësirave;
- zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Duke zbatuar Strategjinë MIBU, Shqipëria do të bëhet një vend me efikasitet ujore, me një menaxhim funksional të integruar të burimeve ujore, ku përdorimi i ujit mbështetet në parimet e qëndrueshmërisë dhe barazisë për përfitime ekonomike të barabarta sociale-gjinore dhe drejtësi mjedisore për të sotmen dhe për brezat e ardhshëm.

Sfidat kryesore me të cilat do të përballlet Shqipëria janë: zvogëlimi në sasi i rezervave ujore, gërshetuar me rritjen e kërkesave të shumëfishta për ujë nga çdo sektor, ndërsa garantohet ruajtja e burimeve ujore për brezat e ardhshëm. Në dhjetëvitet e ardhshme, përdorimi i burimeve ujore për prodhimin e energjisë, furnizimin e popullsisë me ujë, zgjerimin e vaditjes për bujqësinë, industrinë dhe ruajtjen e ekosistemeve ujore do të kërkojë sasi më të mëdha uji dhe përmirësimin e cilësisë së tij.

Kapaciteti i vendit për menaxhimin e burimeve ujore është aktualisht i kufizuar përse i përket burimeve njerëzore, institucioneve, dijes dhe infrastrukturës. Për më tepër, edhe baza e njohurive që nevojitet për hartimin e politikave, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e tyre kërkon përmirësime nëpërmjet ndërhyrjeve specifike të cilat do të çojnë në rritjen e kapaciteteve administrative dhe teknike në nivel kombëtar dhe baseni.

Për t'i bërë ballë këtyre sfidave, menaxhimi i integruar i burimeve ujore të vendit është thelbësor dhe kërkon hartimin e një Strategjie të qartë të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (MIBU). Përmes zhvillimit të kësaj strategjie, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) ka si qëllim të trajtojë dhe të shërbejë si udhëzues për politikën për ujin, dhe të nxisë zhvillime operationale dhe investime ndërmjet të gjithë sektorëve brenda një afati kohor 10 vjeçar.

Problematikat kryesore të burimeve ujore në Shqipëri:

### **1. Shpërndarje jo në mënyrë të barabartë e burimeve ujore:**

Vlerësimet tregojnë se edhe pse burimet ujore janë shpërndarë në mënyrë jo të barabartë në territorin e vendit, e gjithë Shqipëria konsiderohet si një shtet me ujë të bollshëm me burime ujore të rinovueshme të mjaftueshme.

**2. Efektet e parashikuara të ndryshimit të klimës** tregojnë se deri në vitin 2027, prurjet në Shqipëri do të bien nga 4.5% në 20% në ujëmbledhësit e Lumit të Drinit, Matit dhe Vjosës. Ujërat nëntokësore parashikohet gjithashtu që të pakësohen, ku humbjet më të mëdha do të jenë përgjatë bregdetit Adriatik. Pritet që një ngritje e vogël e nivelit të detit të ndikojë në akuiferët e ujërave të ëmbla nëpërmjet depërtimit të ujit të kripur dhe përmblytjeve të deltave lumore dhe lagunave bregdetare.

### **3. Mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane**

Funksionimi i strukturave për trajtimin e ujërave të ndotura është rritur gjatë dekadës së fundit, por performanca e tyre ende nuk është e mjaftueshme. Më shumë investime dhe mirëmbajtje më e mirë nevojitet për të arritur përmirësime në cilësinë e ujit, siç kërkohet edhe nga standardet evropiane.

**4. Mungesa e trajtimit parësor të ujërave të ndotura në burim,** do të thotë gjithashtu se industrinë joqëllimisht, mund të shkarkojnë ujërat e tyre të ndotura në rrjedhën e sipërme të burimeve ujore që përdoren për furnizim me ujë të popullsisë që banon në rrjedhën e poshtme.

**5. Përdorimi i plehrave kimike në bujqësi** ka çuar në rritjen e niveleve të amoniakut, nitrogenit dhe fosforit në burimet ujore përreth gjë që ka rritur brishtësinë (vulnerabilitetin) e ekosistemeve ujore.

**6. Të gjithat politikat ekzistuese për ujin** përqendrohen në rregullimin dhe planifikimin e përdorimit të ujërave dhe kërkesave për të. Plane të hollësishme sektoriale janë hartuar me qëllim përmirësimin e performancës së sektorit të ujit ose të energjisë.

**Kuadri institucional** është konsideruar nga të gjitha palët e interesit si çështja kryesore që pengon menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Për këtë qëllim është kryer një analizë për nxjerrjen në pah të mangësive specifike bazuar në Kuadrin e OECD për Menaxhimin Ujërave.

### **7. Mangësitë institucionale**

Nga pikëpamja institucionale, menaxhimi i burimeve ujore në Shqipëri pothuajse i centralizuar, pëson ndryshime të vazhdueshme, të cilat kanë çuar në mbivendosjen e përgjegjësive ndërmjet instituteve të nivelit qendror dhe atij vendor, gjë që ka rezultuar në një sektor ujor të fragmentuar, me veprimtari joefikase dhe mungesë transparence.

Rolet në sektorin e burimeve ujore janë shpërndarë në institucione të shumta: Këshilli Kombëtar i Ujit i mbështetur nga STKKU, Drejtoria për Politikën e Burimeve Ujore të MBZHRAU në nivel kombëtar dhe Këshillat e Basenit Ujor dhe Agjencitë në nivel baseni. Megjithëse struktura organizative është relativisht e qartë, aktualisht ka një sërë përgjegjësish që mbivendosen ose që nuk lidhen qartësisht me një organ të dhënë.

### **Mangësitë lidhur me bashkërendimin ndërsektorial**

Bashkërendimi efektiv ndërsektorial është thelbësor për MIBU-n. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për politikat ndërmjet ujit dhe mjedisit, shëndetit, energjisë, bujqësisë, industrisë, planifikimit hapësinor dhe përdorimit të tokës, me bashkëpunim shumëplanësh ndërmjet grupeve të interesit dhe bashkëpunim më të madh ndërmjet vendeve ndërkufitare për përdorimin e burimeve ujore.

### **8. Mangësitë e të dhënave dhe informacionit**

Mangësia kryesore është mungesa e metodave për shkëmbim të dhënash dhe informacion të vlefshëm për ujin dhe në lidhje me ujin.

### **9. Mangësitë financiare**

Mobilizimi dhe akordimi i financimeve për sektorin ujor në mënyrë efikase, transparente dhe në kohë është një mangësi e dukshme. Parimet e BE-së për politikën e mjedisit, siç janë parimet “ndotësi paguan” dhe “përdoruesi paguan”, si dhe pagesa për shërbimet mjedisore janë përfshirë në rregulloret Shqiptare.

## **10.Mangësitë ligjore**

Sistemit Shqiptar i mungon legjislacioni përkatës dytësor (aktet nënligjore), përsa i përket menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe mekanizmat e zbatimit që duhet të përcaktohen, me qëllim ofrimin e një sektori efektiv dhe të integruar të ujit.

## **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi propozohet duke u mbështetur në shkronjën b), të pikës 4, të nenit 8, të nenit 102 të Ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2013, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të VKM nr. 636, datë 31.07.2013 “Për miratimin e Marrëveshjes së Grantit Suedezi Nr. TF 014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve Grant të siguruara nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore”.

Përgatitja e këtij dokumenti është realizuar në kuadër të Komponentit 3, të projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, me nr. Ref. MEFWA/CS/003 “Përgatitja dhe Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore”.

Strategjia është hartuar duke marrë në konsideratë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI) së bashku me strategjitë e sektorit, strategjitë ndërsektoriale, master planet dhe planet e veprimit, të cilat formojnë kuadrin e zhvillimit gjithëpërfshirës strategjik të Shqipërisë.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-së (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Strategjia Kombëtare MIBU do të shihet si një dokument i përgjithshëm që përmbledh të dyja politikat e Bashkimit Evropian për ujin dhe mjedisin, ndërsa integron njëkohësisht edhe përjasjet dhe objektivat e Politikave Kombëtare për

menaxhimin e ujit duke u bazuar në katër “shtyllat strategjike”, d.m.th: Ujë për Njerëzit, për Ushqim, për Mjedisin, dhe për Industrinë dhe Energjinë, ndërkohë që merren parasysh parashikimet e pritshme dhe rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike.

Strategjia ndërthur parimet e MIBU-s me Politikën Mjedisore të BE-së për Ujin (sipas direktivës 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2000).

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektakti miraton Strategjinë Kombëtare të MIBU. Ky dokument është hartuar në përmbushje të kërkesave të Urdhrit të Kryeministrit nr. 93, datë 7.08.2012, për “Përgatitjen e Strategjive Sektoriale e Ndërsektoriale Kombëtare” për periudhën 2013-2020, si dhe dokumenteve strategjike sektorial 2013-2020, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”.

Strategjia është organizuar në trajtimin e 5 çështjeve të rëndësishme:

### **1. Kushtet aktuale në Shqipëri, e cila trajton:**

- Burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Përdorimet aktuale të ujit;
- Klima dhe efektet e saj;
- Kuadrin ligjor dhe atë institucional.

### **2. Tek kapitulli “Vizioni, Politikën dhe Qëllimet Strategjike”trajtohen:**

- Vizionin mbi Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore dhe Direktivën Kuadër të Ujit,
- Politikën dhe Parimet e BE-së,
- Politikën dhe Strategjitë ekzistuese për menaxhimin e ujit,
- Planifikimin e investimeve të infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura urbane,
- Analizën e mangësive lidhur me përdorimet e ujit, si dhe
- Objektivat strategjike.

### **3. Tek kapitulli “Objektivat e politikës dhe rezultatet kryesore”trajtohen:**

- Objektivat e politikave që lidhen me sasinë e ujit,
- Objektivat e politikave për cilësinë e ujit,
- Objektivat e politikave lidhur me rreziqet që vijnë nga uji,
- Objektivat e politikave lidhur me informacionin për ujin,
- Objektivat e politikës lidhur me menaxhimin e ujit,

- Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave për menaxhimin e ujit,
- Rezultatet kryesore.

#### **4. Kapitulli “Burimet financiare” trajton aspektet e financimit të zbatimit të kësaj Strategjie, si:**

- Kostoja e zbatimit të Strategjisë,
- Buxheti i shtetit, si burim financimi,
- Burime të jashtme financimi,
- Nevoja shtesë për periudhën buxhetore 2016-2018, si dhe tabelat financiare.

#### **5. Kapitulli “Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi” trajton:**

- Objektivat Strategjike,
- Objektivat e Politikave,
- Sasia e Ujit,
- Cilësia e ujit,
- Rreziqet që vijnë nga uji,
- Informacioni për ujin,
- Menaxhimi i ujit.

Në strategji është trajtuar edhe Plani i veprimit 2016-2018.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Organet për zbatimin e këtij projektvendimi janë organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, të cilat janë përmendur në tekstin e këtij dokumenti.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

1. Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
2. Grupi ndërinstytucional i punës, i ngritur me urdhërin nr. 449, datë 22.09.2015 të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave, për përgatitjen e këtij dokumenti;
3. Konsulenti Mott MacDonald, në bashkëpunim me Abkons dhe GR Albania, në sajë të komponentit të projektit “Për burimet ujore dhe ujitjen” i financuar nga Banka Botërore dhe SIDA;
4. Sekretariati Teknik pranë KKU-së;

## 5. Agjencitë e Baseneve Ujore.

### **Procesi i konsultimit të draft Strategjisë me palët e interesuara:**

Dokumenti i draft Strategjisë është publikuar dhe konsultuar me palët e interesit gjate gjithë procesit në nivelin e autoriteteve kombëtare dhe vendore, shoqërisë civile (OJQ-ve) dhe komuniteteve, nëpërmjet informuesve kyç dhe fokus grupeve që përfaqësojnë grupet vulnerabël (p.sh. gratë, të moshuarit, minoritetet dhe/ose grupet etnike). Forumi i Palëve të Interesit u organizua nga konsorciumi Mott MacDonald, Abkons dhe GR Albania, më datë 7 Dhjetor 2016.

Konkretisht janë zhvilluar:

- Konsultimi me palët e interesit në nivel kombëtar, që përfshin institucionet qendrore;
- Konsultimi me palët e interesit në nivel rajonal dhe vendor, që përfshin institucionet e njësive vendore;
- Fokus grupi i organizuar me grupet vulnerabël (gratë, të moshuarit, komunitetin Rom [nëse ka] dhe grupe të tjera);
- Intervista me informues kyç;

Procesi i angazhimit të palëve të interesit përfshiu gjithashtu intervistimin e një sërë fokus grupesh dhe informuesish kyç për çështjet e ujit në të gjashta basenet ujore, Drin-Buna, Seman, Vjosa, Ishëm-Erzen, Shkumbini dhe Mati. Grupet që ishin në fokusin e procesit të angazhimit të palëve të interesit janë minoritetet, si minoriteti Rom dhe Egjiptian, të moshuarit dhe informues të tjerë kyç si fermerët, që e përdorin dhe menaxhojnë ujin, dhe punonjësit shëndetësorë që kanë nevoja jetike të përdorimit të ujit në procesin e punës së tyre të përditshme.

Numri total i personave të kontaktuar është 77, nga të cilët 44 janë gra. Bazuar në grupet e palëve të interesit të identifikuara më sipër, konsultimet ballë për ballë në nivel kombëtar dhe takimet publike në nivel rajonal janë organizuar për fokus grupe dhe informues kyç.

Departamentet e ndryshme përfaqësuese të institucioneve janë ftuar për të marrë pjesë në të njëjtin takim. Takimet plenare në nivel rajonal/rrethi janë organizuar në fushën e studimit të vlerësimit të alternativave, intervista me informuesit kyç dhe fokus grupet me grupe vulnerabël për të parë ndikimin e këtij projekti në jetën dhe aktivitetet e përditshme. Njoftimet në nivel kombëtar janë bërë nëpërmjet ftesave për të përcaktuar ditën dhe orën e takimit. Të gjitha takimet në nivel kombëtar janë organizuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Përsa u përket takimeve rajonale, ato janë zhvilluar në bashkëpunim me pjesëmarrësit kryesorë dhe me përfaqësuesit rajonalë dhe vendorë. Njoftimet janë bërë nëpërmjet telefonit për të informuar pjesëmarrësit për takimin. Përveç sesioneve P&P (Pyetje & Përgjigje), pjesëmarrësve u janë shpërndarë formularë

për të bërë vlerësimin e aktiviteteve informuese të kryera, dhe regjistrimin e vëzhgimeve dhe shqetësimeve.

Takimet me fokus grupet dhe informuesit kyç janë organizuar me anëtarët e grupeve përkatëse të industrisë ose pjesë të veçanta të projektit. Kjo përfshin shoqatat bujqësore, shoqatat e përdoruesve të ujit, rritësit e pemëve dhe përfaqësimin e shoqërisë civile. Disa materiale komunikimi janë përgatitur dhe përdorur gjatë takimeve për të bërë një prezantim të shkurtër për projektin. Çdo pjesëmarrësi i është dhënë një fletëpalosje me një përmbledhje të shkurtër të projektit. Në fletëpalosje gjendet edhe faqja e internetit të projektit, e cila është e hapur vetëm për fazën e konsultimit. Gjatë fazës së parë të procesit të konsultimit, konsultimi publik, me takime kombëtare dhe rajonale, filloi në datën 10 prill 2016 dhe përfundoi më 12 maj 2016, ku çdo aktor dhe palët e interesit mund të bënte komente ose sugjerime në faqen e internetit [www.iwrm.al](http://www.iwrm.al).

Në faqen e internetit është publikuar gjithashtu kalendari i takimeve për të ftuar pjesëmarrësit dhe palët e tjera përkatëse të interesit. Komentet dhe sugjerimet e bëra në faqen e internetit lidhen drejtpërdrejtë me adresën e email-it të ministrisë dhe konsulentit.

Në faqen zyrtare të projektit dhe në atë të MBZHRAU është publikuar draft Strategjia finale dhe një përmbledhje e shkurtër e vizionit, synimet dhe objektivat e kësaj Strategjie.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Kostoja e përlllogaritur e kësaj Strategjie është e bazuar në Programet e Buxhetit Afatmesëm për periudhën 2016-2018.

Tabela me poshtë jep në mënyrë të përmbledhur koston e secilit Objektiv Strategjik, dhe rrjedhimisht koston totale të Strategjisë.

Detaje të çdo zëri financiar të parashikuar në objektivat e politikës së MIBU, gjenden në dokumentin e draft Strategjisë.

### **Kosto totale dhe financimi në mbështetje të objektivave të politikës MIBU (në /000,000 Lekë)**

Objektivat strategjike dhe nënobjektivat të mbuluara nga dokumenti strategjik	Kosto Totale (në /000,000 Lekë)	Kosto Totale (në /000,000 Eur)	Financimi (në /000,000 Lekë)	Mangësitë (në /000,000 Lekë)	Komente mbi mangësitë financiare të objektivave
<b>TOTALI</b>	<b>239,865.71</b>	<b>1,713.32</b>	<b>216,118.49</b>	<b>21,560.35</b>	
Sasia e Ujit	218,826.86	1,563.05	204,000.00	19,000.00	Afërsisht produkte me vlerë 10 Miliardë Lekë janë parashikuar në programin buxhetor

Objektivat strategjike dhe nënobjektivat të mbuluara nga dokumenti strategjik	Kosto Totale (në /000,000 Lekë)	Kosto Totale (në /000,000 Eur)	Financimi (në /000,000 Lekë)	Mangësitë (në /000,000 Lekë)	Komente mbi mangësitë financiare të objektivave
					"Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime" janë jashtë Tavanit të të njëjtit Program Buxhetor. Nderkohe 9 Miliardë Lekë janë Kërkesat Shtesë jashtë Taveve për Menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
Administrimi i ujit	8,565.20	59.10	7,813.40	461.00	
Cilësia e Ujit	3,237.05	23.12	2,537.00	700.05	
Informacion për ujin	1,420.39	10.15	1,420.39	-	
Rreziqet nga uji	1,747.00	55.83	347.70	1,399.30	Hartimi i Planit Kombëtar menaxhimit të katastrofave dhe zbatimi i tij nuk është parashikuar në PBA 2016-2018

### Buxheti i parashikuar për periudhën 2019-2027 (në /000,000 ALL)

Nën-sektori	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit	182.29	187.03	191.89	196.88	202.00	207.25	212.64	218.16	223.84
Administrimi i ujit	443.23	454.76	466.58	478.71	491.16	503.93	517.03	530.47	544.26
Programet për mbrojtjen e mjedisit	2,561.24	2,627.83	2,696.15	2,766.25	2,838.18	2,911.97	2,987.68	3,065.36	3,145.06
Emergjencat civile	148.77	152.64	156.61	160.68	164.86	169.14	173.54	178.05	182.68
Furnizimi me ujë dhe kanalizime	8,040.76	8,249.82	8,464.32	8,684.39	8,910.18	9,141.85	9,379.54	9,623.40	9,873.61
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	2,989.42	3,067.15	3,146.89	3,228.71	3,312.66	3,398.79	3,487.16	3,577.82	3,670.85
Planifikimi, Administrimi & Menaxhimi (ADF)	2,199.06	2,256.24	2,314.90	2,375.09	2,436.84	2,500.20	2,565.20	2,631.90	2,700.32
<b>Totali (në /000,000 Lekë)</b>	<b>16,564.77</b>	<b>16,995.45</b>	<b>17,437.34</b>	<b>17,890.71</b>	<b>18,355.86</b>	<b>18,833.12</b>	<b>19,322.78</b>	<b>19,825.17</b>	<b>20,340.63</b>
<b>Totali (në /000,000 Euro)</b>	<b>118.32</b>	<b>121.40</b>	<b>124.55</b>	<b>127.79</b>	<b>131.11</b>	<b>134.52</b>	<b>138.02</b>	<b>141.61</b>	<b>145.29</b>

Referuar Kontratës me numër reference MEFWA/CS/003, për “Përgatitjen dhe Zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore”, e amenduar me Amendamentin Nr. 2, datë 5 shkurt 2016, me Amendamentin Nr. 3, datë 30 maj 2016, me Amendamentin Nr. 4, datë 30 shtator 2016, e cila përfundon në datën 23 dhjetor 2016, si dhe bazuar në Urdhërin e Ministrit nr. 321, datë 04.06.2015, pika 1/b, për Monitorimin dhe Implementimin e kësaj kontrate, ministria mori në dorëzim draft Strategjinë e përgatitur nga Konsulenti JV Mott Mac Donald Ltd (UK)&A&B Business Consulting Ltd (Albania) & Gr Albania Ltd Albania, në përputhje me Termat e Referencës.

Sa më sipër, DPBU duke marrë në konsideratë vlerësimin përfundimtar nga grupi ndërinstitucional të punës, reflektimin e komenteve nga konsulenti, me përjashtim

të atyre nga STKKU, përcjellim dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore për shqyrtim dhe miratim në KKU.

**MINISTRI**

**EDMOND PANARITI**